



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E PËRMBARUESVE GJYQËSORË PRIVATË
Përmbaruesi Gjyqësor Privat Shefik Suparaku

Adresa: Lagj. "Kongresi Elbasanit", Rr. "Koço Brisku", Pallati nr.45/6, kati I, Elbasan, Tel: +355 54516212, e-mail: shefik_suparaku@live.com

Nr.192-08 Regj

Elbasan, më 19.11.2020.

URDHËR
"PËR VËNIEN E SEKUESTROS KONSERVATIVE"

Drejtuar : Qendrës Kombëtare të Biznesit(Q.K.B-së).

Adresa : Bly "Zhan D'Ark", ish shtëpia e ushtarakëve, Tiranë.

Për dijëni: Shoqëria "ERNIKU" sh.p.k, NIPT J71925004S, me administrator z. Iljaz Spahiu.

Adresa : Sheshi "Rilindja" Qendra e Biznesit "Karl Topia", Kulla 3, kati 3-të, Tiranë.

Për dijëni: Shoqëria "GJONI-AN" sh.p.k, me NIPT K92223011V me administrator z. Pashk Pepkolaj.

Adresa: Pinar, Rruga Zall Herri ri, godine 3 kateshe, nr.3, kati parë, Tiranë.

Për dijëni: Shoqërisë "Bushtrica Energy 2009" sh.p.k, NIPT K98505601E, administrator znj. Sofia Mano dhe z. Ilmi Loshi.

Adresa: Lagja 1, pallati 7, shkalla 1, Librazhd.

Pranë Përmbaruesit Gjyqësor Privat Shefik Suparaku, me kërkesë të palës kreditore është regjistruar për ekzekutim çështja përmbarimore me numër 192 regj. dhe me palë:

Kreditor – Shoqëria "GJONI-AN" sh.p.k, me NIPT K92223011V.

Debitor – Shoqëria "ERNIKU" sh.p.k, NIPT J71925004S.

Objekti – Likuidim faturash tatimore dhe pagesë kamatash ligjore.

KONSTATOVA:

Me vendim të përmbaruesit gjyqësor si dhe mbështetur në nenin 519 të K.Pr.Civile, është kaluar në ekzekutim të detyrueshëm të urdhërit të ekzekutimit Vendimin Gjyqësor për lëshim urdhëri ekzekutimi nr. 5041 datë 01.10.2020 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, lëshuar për titujt ekzekutivë fatura tatimore shitje sipas përshkrimit të urdhër ekzekutimit të sipërcituar.

Sa sipër duhet të kryhet vendosja e sekuestros mbi aksionet/kuotat që debitori Shoqëria "ERNIKU" sh.p.k, NIPT J71925004S zotëron tek Shoqëria "Bushtrica Energy 2009" sh.p.k, NIPT K98505601E.

Për këtë arsye :

Në bazë të neneve 527 e në vijim të K.Pr.Civile,

URDHËROJ:

1. Vendosjen e masës së sekuestros konservative mbi aksionet/kuotat që debitori Shoqëria "ERNIKU" sh.p.k, NIPT J71925004S, zotëron tek Shoqëria "Bushtrica Energy 2009" sh.p.k, NIPT K98505601E, si dhe mbi të drejtat që rrjedhin nga zotërimi i këtyre aksioneve/kuotave duke ndaluar tjetërsimin dhe/ose disponimin e tyre.
2. Aksionet/kuotat do të qendrojnë të sekuestruara deri në një urdhër të dytë nga ana jonë.
3. Për veprimin apo mosveprimin tuaj, duhet të na vini në dijeni shkresërisht brenda afatit ligjor.
4. Per personat që bëhen pengesë në zbatimin e këtij urdhëri do të merren të gjitha masat e parashikuara në nenin 598 e në vijim të K.Pr.Civile, si dhe në rast se ka vend do të kërkohej ndjekje penale në baze të dispozitave të Kodit Penal.
5. Ky urdhër mbahet e ju njoftohet palëve të cilat kanë të drejtën e ankimit në gjykatë brenda 5 (pesë) ditëve nga marja dijëni.

PËRMBARUESI GJYQËSOR
Shefik SUPARAKU